



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:178450  
Datë: 16.04.2024  
Numri i dokumentit: 05597670

**C.nr.1640/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.S. nga Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson Faruk Binakaj, avokat nga Peja, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Prsig, Rr. "Eduart Liri", me seli në Prishtinë, me bazë juridike zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro, në seancën e datës 02.04.2024 mori, ndërsa me datën 16.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditësit Xh.S. nga Komuna Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Prsig, me seli në Prishtinë, e parashtruar me datë 16.12.2020, me bazë juridike zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1,000 euro.

**II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, paditësi Xh.S. nga Peja, përmes të autorizuarit të tij, me datë 16.12.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Prsig, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1,000 euro.

Gjykata, me datën 02.04.2024, ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk kanë prezantuar asnjëra palë në procedurë, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, në seancë nuk kanë prezantuar dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Sipas nenit 409 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *"Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit"*. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezultojnë se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 409 par.1, 387 par.1 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.1640/20, me datë 02.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

Numri i lëndës: 2020:178450  
Datë: 16.04.2024  
Numri i dokumentit: 05597670

Numri i lëndës: 2020:178450  
Datë: 16.04.2024  
Numri i dokumentit: 05597670